



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.2092/2017

28.02.2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshem, Divizioni Penal, sipas gjyqtarit Adem Shabani, me procesmbajtësin Zyrtarin Ligjor Blend Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga [REDACTED], me vendbanim në [REDACTED], për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1042-1/2017, e datës 15.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Bahri Hyseni të akuzuarit, me dt.15.01.2018, solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga [REDACTED], me vendbanim [REDACTED], i lindur me dt [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme, i pa martua, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër persona [REDACTED], i pa denuar deri me tani mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sespe me dt. 04.06.2017, rrethë orës 03:30, në fshatin [REDACTED], i pandehuri nga pakujdesia, ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jeten e njerëzëve dhe pasurinë si dhe ka vepruar në kundërshtim me dispoziten e nenit 61 .1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që deri sa drejtonte automjetin e tipit " Opel Combo ", me targë të regjistrimit [REDACTED], ngjyrë e bardhë, duke dalë nga parkingu i restorantit " Internacional ", pa u siguruar se me këtë veprim nuk do ti pengoj ose rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, kyçet në rrugën kryesore, kugoditet në anësoren e pasme të anës së majtë të automjetit, me ansoren e përparme të anës së majtë nga automjeti i markës " Opel Vectra ", me targë të regjistrimit [REDACTED], ngjyrë hiri, të cilën e drejtonte i dëmtuari [REDACTED], i cili lëvizte nga drejtimi Ferizaj-Prishtinë, përveq dëmeve në automjet, lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit ka pësuar [REDACTED],-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton:

Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptoi DËNIM ME GJOBË në shumën prej 200 € (dyqind Euro).

Në mbështetje të nenit 46 par.5 1 të KPK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë me pëlqimin e të dënuarit ditën e komunikimit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme prej 80 (tetëdhjetë) orë, të cilën punë do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovëues i Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditët, javët që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Në mbështetje të nenit 46 par. 5 të KPRK-së nëse pas kalimit të kohës së caktuar i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj dënimin me gjobë ku për çdo 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, e nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 par.3 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i akuzuari do të vuaj një ditë burgu.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], me vendbanim [REDAKTUAR], rruga [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88 Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1042-1/2017, e datës 15.08.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], me vendbanim në [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj qështje penale me datën 15.01.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar konform nenit 245 par.1 të KPPK-së, ku kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni dhe i akuzuari [REDAKTUAR].

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dënuarit e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

Lidhur me këtë i akuzuari [REDAKTUAR], ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka deklaruar se me veturen etij atë ditë ishte duke dalë nga parkingu i resotorantit "Internacional" është kyçur pa shikuar mirë mbrapa ku ka ardhur një automjetë dhe e ka goditur në anësoren e pasme të anës së majtë dhe përkundër marrjes së veprimeve në atë moment që mos të vi deri te aksidenti është shkaktuar, fatbardhsisht nuk ka pasur lëndime të rënda trupore askush pos dëmeve pameeriale të veturave i është penduar për verën e kryer, i kërkon falje të dëmtuarit hera tjer gjithëher do të jetë i kujdesëshëm në komunikacion, është hera par që ndeshet me shkeljen e ligjit ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë për bazë pranimin e fajsis dhe se është i pa punë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi korrespondon edhe me rprovat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të tillë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në ekspertizën dhe mendimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.13.07.2017, lidhur me lëndimi e të dëmtuarit [REDAKTUAR] mendimin e ekspertit të Komunikacionit Rrugor i dt.24.06.2017, në skicen e vendit të ngjarjes së aksidentit të komunikacionit si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar gjendje faktike se i akuzuari e ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që një pranimi i tillë mbështetet në aktin akuzues dhe provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata pas marrëjes së mendimit nga prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit kundër të akuzuarit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin e kryerjes së veprës

penale, i pa punë, sjelljen e tij korrekte në shqyrtimin fillestar, ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsërisë, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të akuzuarit i shqiptoj dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro).

Në mbështetje të nenit 46 par.5 1 të KPK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme prej 80 (tetëdhjetë) orë, të cilën punë do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit që i akuzuari të mos kryejë vepra penale të tjera të parandalimit konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin [REDACTED], nga [REDACTED], me vendbanim në [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,

P.nr.2092/2017 me datë 15.01.2018

Zyrtar Ligjor
Blend Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar, ankesa në afat prej 15 ditësh. nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.